



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:086834

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05499971

**P.nr.121/2013**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**-Departamenti për Krime të Rënda, me kryetarin e trupit gjykues -gjyqtarit Ali Kutllovci, dhe antarët e trupit gjykues-gjyqtarët Ferki Xhaferi dhe Leart Rexhaj, me bashkëpunëtorin profesional Arbër Beqiri, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarit I.D, për shkak të veprës penale: Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 pika 4 dhe 11 e lidhur me nenin 20 të KPPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së (Kodit të përkohshëm penal të Kosovës), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.261/09 dt.06.01.2010. Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka bërë rikualifikimin e veprës penale lidhur me të dëmtuarin G.Sh nga Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 pika 4 dhe 11 e lidhur me nenin 20 të KPPK-së në veprën penale Lëndim i rëndë trupor, nga neni 154 par.1 nënpar.5 të KPK-së. Lidhur me të dëmtuarin Sh.Sh ka krijuar dispozitiv të ri duke e kualifikuar si vepër penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së. Prokurori i shtetit pas rikualifikimit ka konstatuar se ka arritur parshkrimi absolut për të tri veprat dhe është tërhequr nga ndjekja penale, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.18.03.2024, e cila ishte e hapur për publikun, në të cilin prezent ishin Prokurori i Prokurorisë Themelore Mitrovicë –Njazi Rexha, i akuzuari I.D dhe mbrojtësi i tij av.Mahmut Halimi, të njëjtën ditë e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa me dt.25.03.2024, e përpilojë këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Ndaj të akuzuarit:**

**I.D**, nga i ati M..., e ëma Xh..., e vajzërisë S..., ‘‘data e lindjes’’, në fsh....-Komuna e Skenderajit, tani jeton në S..., Rruga ‘‘...’’ pn, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.pers....., i martuar, baba i katër fëmve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjës së mesme

ekonomike, i pa dënuar, ndaj tij nuk udhëhiqet procedurë penale ka qenë në paraburgim nga dt.29.07.2009 pastaj në masën e arrestit shtëpiak deri më dt.16.09.2009.

**Në bazë të dispozitës ligjore nga neni 362 par.1 nën par.1.1 të KPP-së:**

## **REFUZOHET AKTAKUZA**

### **Sepse:**

Më 25.06.2009 rreth orës 17:00 min, në Skenderaj në rrugën "... ...." në kafenen "H...." pas një mosmarveshje rreth shkputjes së kontratës së punës të Sh.Sh në Afganistan, shtënë me pistolet të markes "TT" të kal.7.62 mm dhe të dëmtuarin G.Sh i shkakton thyerje të femurit të majtë në pjesën e jashtme multifragmentar –dëmtime të rënda trupore.

**Me këtë veprim kishte kryer veprën penale:** Lëndim i rëndë trupor, nga neni 154 par.1 nënpar.5 të KPPK-së (Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës)

### **Sepse:**

Në të njëjten ditë, vend dhe kohë si në pikën –I- të dispozitivit të aktakuzës pas mosmarrveshjes rreth shkputjes së kontratës së punës të Sh.Sh në Afganistan, shtënë me pistolet të markës "TT" të kal.7.62 mm dhe të dëmtuarin Sh.Sh i shkakton plagë tejshpuese në regjionin e femurit të majtë –lëndime të natyrës së lehtë trupore.

**Me këtë veprim kishte kryer veprën penale:** Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPPK-së (Kodit të përkohshëm penale të Kosovës).

### **Sepse:**

Gjerë me dt.25.06.2009 pa leje valide për mbajtjen e armëve ka poseduar revolen e markës "TT" kal.7.62 mm M-57 me nr.serik 22261.

**Me këtë veprim kishte kryer veprën penale:** Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së.

-I akuzuari lirohet në tërësi nga shpenzimet e procedurës penale për këtë rast.

-Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

## **A r s y e t i m i**

### ***Aktakuza:***

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, me aktakuzën e saj PP.nr.261/09 dt.06.01.2010 e ka akuzuar të akuzuarin I.D, për shkak të veprës penale: Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 pika 4 dhe 11 e lidhur me nenin 20 të KPPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së (Kodit të Përkohshëm Penale të Kosovës).

### ***Rrjedha e procedurës:***

Më dt.18.05.2023, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e palëve. I akuzuari e ka mohuar në tërësi fajësinë për veprat penale Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 pika 4 dhe 11 e lidhur me nenin 20 të KPPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së (Kodit të Përkohshëm Penale të Kosovës).

Mbrojtësi i të pandehurit ka parashtruar kundërshtim të aktakuzës dhe provave.

Gjykata me aktvendimin P.nr.121/13 dt.09.06.2023 i ka refuzuar kundërshtimet e mbrojtësit.

Mbrojtësi ka ushtruar ankes kundër këtij aktvendimi. Gjykata e Apelit me aktvendimin PN.nr.746/23 dt.26.06.2023 e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale janë mbajtur më dt.21.12.2023, dt.02.02.2024, dt.28.02.2024 dhe dt.18.03.2024, seancat kanë qenë e hapur për publikun në të cilën janë proceduar të dëmtuarin dhe dëshmtarët, janë administruar provat materiale, është marrë në pyetje i akuzuari dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve. Shpallja publike e aktgjykimit është bërë në të njëjten ditë, pra me dt.18.04.2024, në prezencë të palëve.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka bërë rikualifikimin e veprës penale lidhur me të dëmtuarin G.Sh nga Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 pika 4 dhe 11 e lidhur me nenin 20 të KPPK-së në veprën penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par.1 nënpar.5 të KPK-së.

Lidhur me të dëmtuarin Sh.Sh, ka krijuar dispozitiv të ri duke e kualifikuar si vepër penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së.

Prokurori i shtetit pas rikualifikimit ka konstatuar se ka arritur parshkrimi absolut për të tri veprat penale dhe është tërhequr nga ndjekja penale.

Pas tërheqjes nga aktakuza nga prokurori i shtetit, gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 362 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, ka marrë aktgjykim me të cilin e ka refuzuar aktakuzën e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.261/09 të dt.06.01.2010, të ri cilësuar në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor nga prokurori i shtetit, duke e akuzuar të akuzuarin I.D, për veprat penale: lidhur me të dëmtuarin G.Sh nga Vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 pika 4 dhe 11 e lidhur me nenin 20 të KPPK-së në veprën penale Lëndim i rëndë trupor, nga neni 154 par.1 nënpar.5 të KPK-së. Lidhur me të dëmtuarin Sh.Sh ka krijuar dispozitiv të ri duke e kualifikuar si vepër penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.4 të KPK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2 i KPPK-së, e për të cilat ka arritur parashkrimi absolut.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së.

Palët e dëmtuara për kërkesën pasurore juridike gjykata i udhëzoi në kontest civil, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 462 par.3 të KPP-së.

Ngase u tha me lartë e bazuar në nenin 362 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

### **Departamenti për Krime të Rënda**

**P.nr.121/2013 dt.25.03.2024**

**Bashkëpunëtori Profesional**  
**Arbër Beqiri**

**Kryetari i trupit gjykues**  
**Ali Kutlovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimi të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.